



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-13
Prishtinë, më 12 dhe 13 shkurt 2015,

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 12 DHE 13 SHKURT 2015**

Seancën e drejtoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmuan: Xhavit HALITI, dhe Sabri HAMITI, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Ai i njoftoi deputetët se kryeministri i Kosovës, z. Isa Mustafa, nëpërmjet një shkrese drejtuar Kryesisë së Kuvendit, ka shfaqur gatishmërinë e tij për të raportuar në Kuvend lidhur me bisedimet dhe Marrëveshjen e arritur me kryeministrin e Serbisë, me ndërmjetësimin e BE-së, në Bruksel, më 9 shkurt 2015.

Në lidhje me këtë çështje diskutoi Visar Ymeri, në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Më pas, kryetari e hodhi në votim propozimin që informimi i kryeministrit të Kosovës, z. Isa Mustafa, për takimin e tij me kryeministrin e Serbisë, në Bruksel, të radhitet si pikë nr. 4 e rendit të ditës së seancës së sotme.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi propozimin që raportimi i kryeministrit të Kosovës, z. Isa Mustafa, për takimin e tij me kryeministrin e Serbisë, në Bruksel, të radhitet si pikë nr. 4 e rendit të ditës së seancës së sotme.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Agim Çeku, Njomza Emini, Visar Ymeri, Ramush Haradinaj, Zafir Berisha, Xhevahire Izmaqi, Doruntinë Maloku-Kastrati dhe kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Alma Lama, parashtoi pyetje për ministrin, Hajredin Kuçi, në lidhje me kohën se kur pritet të dërgohet në Kuvend Projektligji për statusin juridik të bashkësive fetare në Kosovë.

Ministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albulena Haxhiu, parashtoi pyetje për ministrin, Hajredin Kuçi, në lidhje me humbjet dhe veprimet e ndërmarra, që sipas Raportit të Auditorit të Përgjithshëm, Administrata Publike në përgjithësi, shumicën e lënëve gjyqësore i ka të humbura në procedurat gjyqësore ku si palë e paditur janë institucionet publike.

Ministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albulena Haxhiu, parashtoi pyetje për ministrin, Hajredin Kuçi, në lidhje me atë se a ka qenë ai i njoftuar për çështjen e vazhdimit të kontratave të punës për dy zv/drejtorë të Shërbimit Korrektues, siç tha ajo, në mënyrë të kundërligjshme, nga drejtori i Shërbimit Korrektues, kur dihet se ky i fundit i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit të Drejtësisë.

Ministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Vjosa Osmani, parashtoi pyetje për zv/kryeministrin, Hashim Thaçi, në lidhje me numrin e njohjeve të konfirmuara që ka Republika e Kosovës. A janë njohjet nga Uganda dhe Nigeria, njohje të konfirmuara dhe a ka pasur tërheqje të njohjes nga Mali apo nuk ka pasur fare njohje nga ky shtet.

Zv/kryeministri, Hashim Thaçi Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Lahi Brahimaj, parashtoi pyetje për ministrin Memli Krasniqi, në lidhje me parandalimin e prodhimit të farës së grurit nga prodhuesit ilegal dhe të palicensuar.

Ministri Memli Krasniqi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti, Ismajl Kurteshi, parashtoi pyetje për ministrin Lubimir Mariq, në lidhje me atë se si ministër në Qeverinë e Republikës së Kosovës, në të cilën pozitë jeni nga data 9 dhjetor 2014, a e njihni Pavarësinë e Republikës së Kosovës?

Ministri Lubimir Mariq nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Blerta Deliu-Kodra, parashtoi pyetje për ministrin, Imet Rrahmani, në lidhje me atë se a do të sigurohen citostatikët e nevojshëm për pacientët në QKUK, të cilët në mungesë të tyre po detyrohen t'i sigurojnë ato me mjete vetjake.

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetes Blerta Deliu-Kodra.

Deputeti Haxhi Shala, parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani, në lidhje me deklaratën e Dragan Jablanoviqit, anëtar i ekipit drejtues për formimin e Asociacionit të Komunave Serbe, lidhur me kompetencat e këtij Asociacioni në fushën e planifikimit hapësinor.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Haxhi Shala.

Deputeti Zafir Berisha, parashtroi pyetje për ministrin Hajredin Kuçi, në lidhje me ligjëratën e mbajtur, siç tha ai, të dënuarit Ramadan Muja, para prokurorëve të shtetit dhe sa është kjo ligjore.

Ministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Teuta Haxhiu, parashtroi pyetje për kryeministrin, Isa Mustafa, në lidhje me atë se kur do të fillojë zbatimi i kontratës kolektive, e cila është nënshkruar më 18 mars 2014.

Kryeministri, Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetes Teuta Haxhiu.

Deputetja Salihe Mustafa, parashtroi pyetje për ministrin, Imet Rrahmani, në lidhje me formimin e odave të profesionistëve shëndetësorë.

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetes Salihe Mustafa.

Deputeti Daut Haradinaj tha se pyetja me nr. DO-204, e parashtruar për ministrin Haki Demolli është e njëjtë në tekstin e saj, me pyetjen me nr. DO-222, të parashtruar nga deputeti Rustem Berisha, për ministrin Haki Demolli.

Deputeti Daut Haradinaj, parashtroi pyetje për ministrin, Skender Hyseni, në lidhje me atë se ndaj sa zyrtarëve policorë janë marrë masa, apo hetime, kush po i zhvillon këto hetime dhe kur pritet një raport final i situatës për ngjarjet e protestës së mbajtur më 27 janar 2015.

Ministri Skender Hyseni nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Faton Topalli, parashtroi pyetje për ministrin, Skender Hyseni, në lidhje me numrin, moshën dhe gjininë e qytetarëve të Kosovës të larguar nga vendi, në muajin qershor, nëntor e dhjetor 2014, si dhe në janar 2015.

Ministri Skender Hyseni nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Faton Topalli, parashtroi pyetje për ministrin, Arsim Bajrami, në lidhje me numrin e nxënësve që kanë ndërprerë mësimin gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit të kaluar dhe në janar 2015, në nivelin parashkollor, fillor dhe të mesëm.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit Faton Topalli.

Deputetja Salihe Mustafa, parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani, në lidhje me ekzaminimin e nivelit të siguri së digës në liqenin artificial të Përlepnicës.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Salihe Mustafa.

Deputeti Fadil Beka, parashtroi pyetje për ministrin, Imet Rrahmani, në lidhje me vazhdimin apo jo të marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, QKUK-së dhe Spitalit të Mitrovicës. Si do të funksionalizohet reparti i kirurgjisë në Spitalin e Mitrovicës?

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetit Fadil Beka.

Deputetja Alma Lama, parashtroi pyetje për ministren, Hykmete Bajrami, në lidhje me, siç tha ajo, monopolizimin në treg, nga ana e ndonjë kompanie të Kosovës, duke ua imponuar bujqve, që t'ua shesin vetëm asaj kompanie patatet me çmime tepër të ulëta, madje nën koston e prodhimit.

Ministrja Hykmete Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputeti, Rustem Berisha, parashtoi pyetje për ministrin, Blerand Stavileci, në lidhje shtrenjtimin e rrymës, siç tha ai, për çdo muaj në Kosovë.

Ministri Blerand Stavileci iu përgjigj pyetjes së deputetit Rustem Berisha.

Deputetja Time Kadrijaj, parashtoi pyetje për ministrin, Imet Rrahmani, në lidhje me mungesën e ilaçit "CELLCEPT", në Klinikën e Nefrologjisë në SHSKU.

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Informimi i kryeministrit të Kosovës, z. Isa Mustafa, për takimin me kryeministrin e Serbisë, në Bruksel, më 9 shkurt 2015,
5. Propozim-programi i punës së Kuvendit për vitin 2015,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike,
7. Propozimi për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
8. Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Në lidhje me vërejtjen e deputetes Albulena Haxhiu, në procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur me 19 janar 2015, ora 17:00, kryetari dha këtë sqarim:

Në bazë të nenit 43, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, në procesverbalin e seancës plenare evidentohen pikat e rendit të ditës, diskutimet e përmbledhura dhe vendimet që i merr Kuvendi.

Andaj, në procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 19 janar 2015, ora 17:00, është evidentuar votimi përfundimtar lidhur me çështjen e shmangies nga Rregullorja e Kuvendit.

Në bazë të nenit, 17, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, kryetari e bën interpretimin përfundimtar të Rregullores gjatë seancës plenare.

Në transkript është evidentuar në tërësi procesi i votimit.

Deputetja Albulena Haxhiu tha se ka vërejtje në procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 5 shkurt 2015, përkatësisht në procesverbal është evidencuar pyetja që nuk është parashtruar.

Deputetja Albulena Haxhiu ia kishte parashtruar dy pyetje parlamentare Zyrës për Propozime dhe Parashtrës, për këtë seancë, ndërsa një të kishte lexuar në seancë që

kishte të bënte me harmonizimin e legjislacionit për funksionalizimin e Gjykatës Speciale, nuk e kishte parashtruar me shkrim për këtë seancë.

Procesverbali i seancës plenare, dt. 5 shkurt 2015, është përmirësuar sipas vërejtjes së deputetes Albulena Haxhiu.

4. Informimi i kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa për takimin e zhvilluar me kryeministrin e Serbisë, në Bruksel më 9 shkurt 2015

Kryeministri i Kosovës, z. **Isa Mustafa** i njoftoi deputetët e Kuvendit për dialogun e zhvilluar në Bruksel ndërmjet tij dhe kryeministrit të Serbisë, me ndërmjetësimin e përfaqësueses së lartë të Bashkimit Evropian, zonjës Frederika Mogerini. Dialogu i zhvilluar në Bruksel është vazhdimësi e dialogut, i cili është në harmoni me Rezolutën e Kuvendit, të datës 22 prill të vitit 2013, për dhënien e pëlqimit për nënshkrimin e marrëveshjes së parë të parimeve, që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Marrëveshja e arritur në Bruksel, vitin e kaluar, si dhe marrëveshjet e tjera, kanë kontribuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve në planin socio-ekonomik, në lëvizjen e lirë dhe sa i përket sigurisë, në integrimin e qytetarëve serbë të pjesës veriore në institucionet e shtetit të Kosovës, në zhbërjen e strukturave ilegale serbe, në fushat ku janë arritur marrëveshjet, ndërkohë, Kosova ka konsoliduar më tej sovranitetin në gjithë vendin. Për herë të parë, në Kuvendin e Republikës së Kosovës marrin pjesë serbët nga e gjithë Kosova.

Ndër arritjet kryesore të dialogut të Brukselit dhe sfidat që janë paraparë ka pasur përparime të dukshme, në funksionimin ligjor dhe integrimin e katër komunave veriore në institucionet e Kosovës, pas zgjedhjeve të suksesshme lokale në vitin 2013, në përputhje me ligjet e Kosovës dhe me marrëveshjen e Brukselit.

Për çështjet e drejtësisë është zhvilluar një dialog për një periudhë të gjatë kohore, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësuesit dhe ekspertët nga të gjitha fushat, ata të Gjykatës Supreme, të Gjykatës së Apelit, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Prokurorisë së Kosovës. Të gjitha zgjidhjet janë arritur në suaza të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të ligjeve ekzistuese dhe asnjë zgjidhje e pranuar nuk kërkon ndryshimin e ligjeve, por vetëm zbatimin e këtyre ligjeve në territorin e Republikës së Kosovës.

Parimet themelore të dialogut për drejtësinë kanë qenë:

- Sistemi unik i gjyqësorit, përkatësisht një Gjykatë Themelore për tërë rajonin e Mitrovicës, siç është e paraparë me ligj, respektivisht një Prokurori Themelore.
- Gjyqtarët dhe prokurorët të punojnë së bashku dhe jo të ndarë mbi baza etnike,
- Aspekti fizik i gjykatave të rregullohet në mënyrë praktike substancionale, që rastet penale të trajtohen, në objektet e Gjykatës në veri, ndërsa rastet civile, në objektet e Gjykatës Themelore, në jug.
- Kryetari i Gjykatës dhe kryeprokurori, të jenë të përbërjeve të ndryshme etnike, përkatësisht kryeprokurori të jetë shqiptar, kurse kryetari i Gjykatës, serb,

- Numri i gjyqtarëve dhe personelit administrativ të jetë i përafërt me strukturën e popullsisë në këtë pjesë.

Me funksionalizimin e kësaj marrëveshjeje duhet të shuhet të gjitha gjykatat dhe prokuroritë në Serbi, që i referohen territorit të Republikës së Kosovës, sepse kemi pasur gjykata të tilla edhe brenda edhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe po ashtu dokumentacion gjyqësor, i cili ka qenë jashtë dhe i cili do të kthehet në Gjykatën Themelore, përkatësisht në organet e drejtësisë së Kosovës dhe të trajtohet sipas ligjeve të Kosovës.

Kjo marrëveshje, ashtu si edhe marrëveshjet e këtuja para saj, janë arritur pas muajve të tërë negociatash ndërmjet palëve, kurse qëllimi kryesor i ekipit tonë ka qenë integrimi gjyqësor dhe veprimi i tij unik në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Mirëpo, pavarësisht rezultateve shumë të rëndësishme që i kemi arritur me nënshkrimin e Marrëveshjes për drejtësinë, duhet të theksoj se rimëkëmbja e sistemit gjyqësor në një vend gati të izoluar nga ana e drejtësisë tash e 15 vjet, do të jetë një e arritur e madhe për ne, por edhe një sfidë mjaft e madhe për ne.

Në Marrëveshjen për drejtësi nuk ka palë fituese dhe humbëse. Me këtë marrëveshje ka fituar drejtësia, prandaj konsideroj se kanë fituar të gjitha palët, kanë fituar të gjithë qytetarët, ka fituar integriteti dhe sovraniteti i vendit tonë.

Marrëveshja e arritur parasheh një integrim të strukturave të deritanishme të drejtësisë nga veriu i vendit në sistemin gjyqësor të Kosovës, për të aplikuar kështu legjislacionin e Republikës së Kosovës, pika e parë e marrëveshjes e reflekton pikërisht këtë. Në të gjitha pikat e tjera Marrëveshja i referohet harmonisë me ligjet e Republikës së Kosovës.

Për të siguruar gjithëpërfshirje dhe bashkëpunim pas këtij procesi të gjatë negociues, kemi pranuar një përfaqësim më substancial të gjyqtarëve, prokurorëve dhe punonjësve serbë në gjykatat tona në këtë rajon. Kështu, Marrëveshja parasheh një përfaqësim të gjyqtarëve në të gjitha departamentet e Gjykatës Themelore të Mitrovicës. Pjesë e këtij përfaqësimi është edhe udhëheqja e Gjykatës, nga një kryetar - gjyqtar serb, ndërkaq e Prokurorisë, nga një prokuror shqiptar.

Kështu, duke pasur parasysh numrin tashmë të ndryshuar të ngritur të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit mbështetës, prezenca e EULEX-it, por edhe nevoja për gjithëpërfshirje dhe për të maksimalizuar qasjen e qytetarëve në drejtësi, Gjykata Themelore në Mitrovicë, do të jetë e vendosur në dy objekte.

Megjithatë, duhet bërë të qartë se kjo ndarje është bërë vetëm për arsye funksionale dhe infrastrukturore dhe ndarja është bërë në bazë të natyrës së lëndëve që departamentet e ndryshme i punojnë. Kështu, Departamenti i Krimeve të Rënda dhe pjesa e Departamentit të Përgjithshëm që merren me lëndë penale, do të jetë e vendosur në Gjykatën Themelore në veri të qytetit.

Divizioni i Gjykatës së Apelit, në pjesën veriore të Mitrovicës do të përbëhet nga 2 gjyqtarë shqiptarë dhe 5 gjyqtarë serbë dhe do t'i përgjigjet drejtpërsëdrejti Gjykatës së Apelit, kurse Departamenti i Krimeve të Rënda do të përbëhet nga 4 gjyqtarë shqiptarë dhe 4 serbë. Departamenti i Përgjithshëm i cili do t'i gjykojë të gjitha çështjet penale në pjesën veriore dhe jugore të Mitrovicës dhe Zveçanin, do të përbëhet nga 5 gjyqtarë serbë dhe 4 gjyqtarë shqiptarë, është paraparë po ashtu që të jenë 9 prokurorë shqiptarë dhe 9 prokurorë serbë.

Në jug të qytetit do të gjykohen të gjitha lëndët e natyrës civile dhe për të mitur. Prokuroria do të jetë e vendosur në një objekt tjetër, po ashtu në veri të qytetit. Kështu do të garantohet një prani e barabartë e institucioneve të drejtësisë në këtë pjesë të Kosovës.

Integrimi i pjesës veriore të Republikës së Kosovës, është një proces i ndjeshëm, por që po ndodh. Vënia e drejtësisë, e rikthimit të besimit të qytetarëve të kësaj pjese në institucionet e drejtësisë dhe puna e pandërprerë e këtyre institucioneve që do të fillojë së shpejti, do të na dëshmojë të gjithëve se të gjitha sakrificat e bëra gjatë këtyre viteve ia vlejnë.

Zgjidhja e çështjeve të drejtësisë dhe shuarja e mbrojtjes civile e cila do të jetë me prioritet në takimet e ardhshme, do të krijojë mundësi që të diskutojmë për çështjen e krijimit të Asociacionit të Komunave, me shumicë serbe, në bazë të ligjeve ekzistuese të Kosovës si dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ashtu siç e përcakton Marrëveshja e Brukselit.

Fjala e kryeministrit është dhënë e plotë në transkript.

Pas raportimit të kryeministrit Mustafa, kryetari e hapi diskutimin.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Selvije Halimi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albulena Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” Time Kadrijaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Valdete Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Danush Ademi - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Teuta Sahatqija, në emër të Komisionit për Integritet Evropian, Nait Hasani, në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe, Njomza Emini, Bekim Haxhiu, Aida Dërguti, Fatmir Limaj, Salih Morina, Visar Ymeri, Sala Berisha-Shala, Shqipe Pantina, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

5. Propozim-programi i punës së Kuvendit për vitin 2015

Kryesuesi Sabri Hamiti tha se Kryesia e Kuvendit, në bazë të nenit 15 të Rregullores së Kuvendit, ka përgatitur Propozim-programin e Punës së Kuvendit, për vitin 2015.

Programi i punës së Kuvendit për vitin 2015, paraqet dokument bazë të Kuvendit për aktivitetin e Kuvendit si organ ligjvënës, mbikëqyrës dhe përfaqësues.

Ky Propozim-program, tha ai, është hartuar duke u bazuar në këto dokumente:

- Programin Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2015,
- Planet e punës së komisioneve parlamentare për vitin 2015 dhe
- Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Progresit - 2015.

Për përmbushjen e Programit të punës, Administrata e Kuvendit do të ofrojë mbështetje profesionale dhe administrative.

Për mbarëvajtjen e zbatimit të të gjitha aktiviteteve, sipas dinamikës të përcaktuar me këtë program, do të përkujdesen kryetari, Kryesia e Kuvendit dhe sekretari i Kuvendit.

Bartës të zbatimit të këtij programi në radhë të parë janë komisionet parlamentare.

Realizimi i Programit të Punës së Kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Qeverinë, e cila duhet t'i përmbahet Programit legjislativ të Kuvendit për vitin 2015.

Kryesuesi ftoi deputetët e Kuvendit, që të miratojnë Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2015, pastaj që të miratohet propozimi që Qeveria e Republikës së Kosovës t'i procedojë projektligjet e parapara me Planin e veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, për vitin 2015, dhe që Komisionet parlamentare të përshpejtojnë shqyrtimin dhe procedimin e projektligjeve të parapara me Planin e Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, për vitin 2015.

Më pas, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Propozim-programit të punës së Kuvendit për vitin 2015.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Selvije Halimi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albulena Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje" Time Kadrijaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Valdete Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Danush Ademi - në emër të Grupit Parlamentar "6+", Teuta Sahatqija, në emër të Komisionit për Integritet Evropian, Nait Hasani, në emër të Komisionit për Arsime, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rinë dhe Sport, si dhe, Njomza Emini, Bekim Haxhiu, Aida Dërguti, Fatmir Limaj, Salih Morina, Visar Ymeri, Sala Berisha-Shala, Shqipe Pantina, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi hodhi në votim Propozim-programin e Punës së Kuvendit, për vitin 2015.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 67,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Programi i Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2015.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës t'i procedojë në Kuvend projektligjet sipas afateve të parapara me Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2015, si dhe të përshpejtojë procedimin e projektligjeve të parapara me Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Progresit - 2015.
3. Komisionet parlamentare të përshpejtojnë shqyrtimin dhe procedimin e projektligjeve të parapara me Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Progresit - 2015.

Në vazhdim, përfaqësuesit e grupeve parlamentare, propozuan që seanca e sotme t'i përfundojë punimet, ndërsa vazhdimi i saj të bëhet me datë, 13 shkurt në ora 10.

Kryesuesi, me propozim të kryetarëve të grupeve parlamentare, i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 18 e 25 minuta.

13 shkurt 2015, ora 10:00

Vazhdimi i seancës,

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit, Kadri VESELI, ndërsa i ndihmoi, Xhavit HALITI, nënkryetar.

Kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike.

Ministri **Blerand Stavileci**, tha se ky Projektligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike dhe krijimin e bazës juridike që me vendim të Kuvendit të Kosovës të hiqen nga kompetenca e Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërmarrje të caktuara shoqërore ose njësi të caktuara organizative të një ndërmarrje shoqërore dhe këto të regjistrohen si ndërmarrje publike.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Blerand Stavileci, është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij Projektligji.

Për këtë Projektligj diskutuan deputetët: Muhamet Mustafa- në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Besim Beqaj - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Pal Lekaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Fatmir Limaj - në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Duda Balje - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe, kryeministri Isa Mustafa, Muhamet Mustafa, Naim Fetahu, Shpejtim Bulliqi, nënkryetari Glauk Konjufca, Ramush Haradinaj, Enver Hoti, Sala Berisha-Shala, ministri Blerand Stavileci, ministrja Hykmete Bajrami, Sadri Ferati, Ilir Deda, Time Kadrijaj, Shukrije Bytyqi, Rustem Mustafa, Visar Ymeri, Raif Qela, Fatmir Rexhepi, Rexhep Selimi, Daut Haradinaj, Fadil Beka, Naser Osmani, Faton Topalli, Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Teuta Haxhiu, kryetari Kadri Veseli, Salih Morina, Ismajl Kurteshi, Emilija Rexhepi, nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, Hajdar Beqa, Bardhyl Metaj, Pal Lekaj, Fatmir Limaj, Shaip Muja, Bekim Haxhiu, Hatim Baxhaku, Milazim Haliti, Ali Sadriu, Besa Gaxherri, Teuta Sahatqija, Adem Salihaj dhe Blerim Grainca, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike.

Të pranishëm në sallë ishin 70 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon,

Për -----	48,
Kundër -----	22,
Abstenime -----	1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri si Komision FunkSIONAL dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin në përputhje me Rregulloren dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Propozimi për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Deputetja **Albulena Haxhiu**, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, tha se si komision e kemi shqyrtuar propozimet për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Kuvendit i kemi rekomanduar emërimin e tyre.
Fjala e znj. Albulena Haxhiu është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Selvije Halimi - në emër të GP të PDK-së, Armend Zemaj - në emër të GP të LDK-së, Albulena Haxhiu - në emër të GP të Lëvizjes Vetëvendosje, Pal Lekaj - në emër të GP të AAK-së, Haxhi Shala - në emër të GP NISMA, Qerim Bajrami - në emër të GP “6+”, si dhe Albulena Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve kryesuesi Xhavit Haliti, hodhi në votim propozimet për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, si në vijim:

Avdi Dinaj dhe Nebojsha Boriqiq, nga Gjykata Supreme e Kosovës, Idain Ismaili, nga Shoqata e Prokurorëve të Kosovës, Ymer Hoxha, nga Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës, dhe Ramë Gashi, nga Oda e Avokatëve të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----	50,
Kundër -----	1 ,
Abstenime -----	15.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

I. Anëtarë të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës emërohen:

1. Avdi Dinaj, nga Gjykata Supreme e Kosovës,
2. Nebojsa Boriqi, nga Gjykata Supreme e Kosovës,
3. Idain Ismaili, nga Shoqata e Prokurorëve të Kosovës,
4. Ymer Hoxha, nga Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës,
5. Ramë Gashi, nga Oda e Avokatëve të Kosovës.

II. Mandati i të emëruarve nga pika I. e këtij vendimi zgjat dy (2) vjet.

8. Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar “Lista Serbe” ka propozuar deputetin Slavko Simiq, zëvendëskryesues të dytë, në Komisionin parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, në vend të deputetes, Jasmina Zhivković, si dhe Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën”, ka propozuar zëvendësimet në komisionet parlamentare.

Ai kërkoi nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal, me ngritje dore, të deklarohen për propozimin e Grupit Parlamentar “Lista Serbe” dhe Grupit Parlamentar “Nisma për Kosovën”.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Deputeti Slavko Simiq, nga Grupit Parlamentar “Lista Serbe” emërohet, zëvendëskryesues i dytë, në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, në vend të deputetes, Jasmina Zhivković.

II. Nga Grupit Parlamentar “Nisma për Kosovën”, emërohen deputetët, si në vijim:

1. Deputeti Fatmir Limaj, emërohet anëtar në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, në vend të ish-deputetit Jakup Krasniqi.
2. Deputeti Enver Hoti, emërohet anëtar në Komisionin për Buxhet dhe Financa, në vend të ish-deputetit Jakup Krasniqi.
3. Deputeti Enver Hoti, emërohet anëtar në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në vend të deputetit Fatmir Limaj.
4. Deputetja Valdete Bajrami, emërohet anëtare në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në vend të deputetit Fatmir Limaj.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 18:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*